

UDHËZIM

Nr. 19, datë 3.11.2014

**PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË
VEÇANTË TË SKEMËS SË
KOMPENSIMIT TË PRODHUESVE BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT MBI
VLERËN E SHTUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat mbi zbatimin e seksionit 4, të kreut XI, të ligjit 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” për skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë, të cilët në vijim në këtë udhëzim do të referohen me termin “fermer”.

Neni 2

Objekti i skemës së kompensimit

1. Janë objekt dhe i nënshtrohen skemës së kompensimit, fermerët që zhvillojnë aktivitetin e vet në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore, si veprimtari për prodhimin e produkteve bujqë-sore, bimore ose shtazore, në kuadrin e aktiviteteve të përcaktuara dhe të listuara sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 146 të ligjit, skema e kompensimit do të zbatohet për produktet bujqësore të prodhuara në kuadër të aktiviteteve prodhuese bujqësore referuar listës në aneksin III të ligjit, të listuara si më poshtë:

Lista e aktiviteteve prodhuese bujqësore

1. Kultura bujqësore:

- a) bujqësia e përgjithshme, përfshirë vreshtarinë;
 - b) pemëtaria (përfshirë olivokulturën) dhe hortikultura (perimet, lulet dhe bimët zbukuruese), edhe në serra;
 - c) prodhimi i kërpudhave dhe i erëzave, i farërave dhe filizave;
 - ç) prodhimi i fidanëve.
2. Blegtoaria:
- a) mbarështimi i kafshëve;
 - b) mbarështimi i shpendëve;
 - c) mbarështimi i lepujve; ç) mbarështimi i bletëve;
 - d) mbarështimi i krimbit të mëndafshit;
 - dh) mbarështimi i kërmillit.

3. Termat e përdoruar në këtë udhëzim janë të njëjtë me termat e përkufizuar në nenin 145 të ligjit.

Neni 3

Kushte të përgjithshme

1. Fermerët, në kuadër të veprimtarisë së tyre prodhuese, furnizojnë me produkte bujqësore një person të tatueshëm, i cili nuk është objekt i zbatimit të kësaj skemë kompensimi.

2. Fermerët që i nënshtrohen kësaj skeme, konsiderohen ajo kategori e prodhuesve bujqësore të cilët nuk i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së për arsye se aplikimi i regjimit normal të TVSH-së krijon vështirësi administrative.

3. Çdo fermer që i nënshtrohet këtij regjimi, në mënyrë të vullnetshme mund të zgjedhë t'i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së, duke iu nënshtuar çdo të drejte dhe detyrimi për regjistrim, deklarim, llogaritje dhe pagesë të TVSH-së sipas përcaktimeve ligjore.

4. Çdo fermer që furnizon (shet) produktet e tij bujqësore sipas këtij regjimi, qarkullimi vjetor i të cilit është mbi kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, është i detyruar t'i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së duke iu nënshtuar çdo të drejte dhe detyrimi për regjistrim, deklarim, llogaritje dhe pagesë të TVSH-së sipas përcaktimeve ligjore.

5. Fermeri, i cili për qëllime të pikës 3 dhe 4 më sipër i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së, dorëzon në drejtorinë rajonale tatimore certifikatën e NIPT-it me të cilën është pajisur për të përfituar nga skema e kompensimit si fermer, duke u çregjistruar nga kjo skemë kompensimi.

përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme dhe të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit.

4. Për pajisjen me NIPT të fermerit, janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) të dhënat e identifikimit të fermerit; b) adresa e banimit, kontakte të personit;
- b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore;
- c) fusha/(at) e veprimtarisë prodhuese bujqësore, në qoftë se është e përcaktuar, ose nëse fermeri kryen disa veprimtari prodhuese bujqësore, atëherë specifikohen disa duke filluar nga ajo që mban peshën kryesore;
- ç) specimeni i nënshkrimit (firmës) të individit-fermer.

5. Drejtoria rajonale tatimore merr në shqyrtim aplikimet për pajisjen me NIPT të fermerëve sipas radhës së paraqitjes së tyre. Drejtoria e regjistrimit dhe shërbimit të tatimpaguesit në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse asiston aplikantin fermer në plotësimin e aplikimit dhe ndërkohë verifikon:

- a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;
- b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;
- c) paraqitjen në formën e kërkuar të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;
- d) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit përputhen me të dhënat që përmbajnë dokumentet e kërkuara, që shoqërojnë formularin;
- e) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje, apo është i palexueshëm.

6. Drejtoria rajonale tatimore, pasi kryen verifikimet përkatëse dhe vëren përmbushjen korrekte të kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin e fermerit në regjistrin tatimor duke evidentuar dukshëm në faqen e regjistrimit faktin që i regjistruari është “fermer” dhe lëshon certifikatën e regjistrimit (NIPT-in) brenda një afati prej dy ditësh nga data e paraqitjes së aplikimit. Emërtimi në certifikatë shkruan: “Fermeri A.B.” ku AB është emri dhe mbiemri i fermerit.

7. Ky regjistrim dhe certifikata e NIPT-it lëshuar fermerit është e vlefshme vetëm për qëllime të përfitimit nga skema e kompensimit të prodhuesve bujqësorë sipas këtij ligji. Çdo përdorim i NIPT-it të lëshuar fermerit nga ana e tij apo nga persona të tjerë për qëllime të tjera të ndryshme nga ajo e

përcaktuar në këtë udhëzim është në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të tij.

Neni 4

Kushtet për të përfituar nga skema e kompensimit

1. Fermeri përfiton të drejtën e kompensimit për sa kohë qarkullimi vjetor i tyre, bazuar në shitjet e kryera për produktet bujqësore kundrejt personave të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit, sipas vlerës totale të furnizimit të shënuar në faturë, nuk tejkalon kufirin minimal të përcaktuar të regjistrimit për TVSH-në.

2. Fermerët që i nënshtrohen këtij regjimi, janë përfitues të skemës së kompensimit nëse furnizojnë mallra me prejardhje nga puna e tyre e kryer për aktivitetet prodhuese bujqësore të përcaktuara sipas këtij udhëzimi.

3. Fermerët që janë objekt i skemës së kompensimit, duhet të pajisen me një numër identifikimi (NIPT), lëshuar nga drejtoria rajonale tatimore ku ushtron aktivitetin fermeri për të përfituar nga kjo skemë, pa iu nënshtruar detyrimit për deklaram.

Neni 5

Pajisja me NIPT e fermerit

1. Aplikimi për t'u pajisur me NIPT bëhet nga vetë fermeri.

2. Për t'u pajisur me certifikatën e NIPT-it, individ-fermer paraqitet në Drejtorinë e Regjistrimit dhe Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore të juridiksionit sipas ndarjes, organizimit administrativ, duke paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Aplikimin për regjistrim sipas formularit përkatës të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme të kërkuara, nënshkruar nga kërkuesi.

- Dokumentin origjinal të identifikimit (letërnjoftimit)/ose kopje të noterizuar të këtij dokumenti, i cili i bashkëngjitet aplikimit për regjistrim.

- Vërtetimin origjinal sipas formatit bashkëngjitur këtij udhëzimi, lëshuar për fermerin prej drejtorisë rajonale të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në bazë të të cilit vërtetohet aktiviteti prodhues bujqësor i fermerit.

Për aktivitetin prodhues bujqësor që kryhet në të njëjtin vend/adresë (tokë bujqësore ose adresë ku kryhet veprimtaria bujqësore/blegtorale) në pronësi ose në përdorim, ky vërtetim, për qëllime të pajisjes me NIPT, lëshohet vetëm në emër të një fermeri.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 10, datë 3.5.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.75, datë 5 maj 2016).

3. Dokumentet shoqëruese të aplikimit duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin, të jenë në gjuhën shqipe, nuk duhet të përmbajnë korrigjime ose fshirje dhe përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme dhe të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit.

4. Për pajisjen me NIPT të fermerit, janë të detyrueshme këto të dhëna:

a) të dhënat e identifikimit të fermerit, adresa e banimit, kontakte të personit;

b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore. Për të njëjtin vend të veprimtarisë /adresë të ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore, pajiset me NIPT, vetëm një fermer i cili ka në pronësi ose në përdorim dhe ushtron veprimtarinë në këtë vend.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 10, datë 3.5.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.75, datë 5 maj 2016).

c) vendi i ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore;

d) fusha/(at) e veprimtarisë prodhuese bujqësore, në qoftë se është e përcaktuar, ose nëse fermeri kryen disa veprimtari prodhuese bujqësore, atëherë specifikohen disa duke filluar nga ajo që mban peshën kryesore;

ç) specimeni i nënshkrimit (firmës) të individit-fermer.

5. Drejtoria rajonale tatimore merr në shqyrtim aplikimet për pajisjen me NIPT të fermerëve sipas radhës së paraqitjes së tyre. Drejtoria e regjistrimit dhe shërbimit të tatimpaguesit në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse asiston aplikantin fermer në plotësimin e aplikimit dhe ndërkohë verifikon:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;

b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;

c) paraqitjen në formën e kërkuar të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;

d) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit përputhen me të dhënat që përmbajnë dokumentet e kërkuara, që shoqërojnë formularin;

e) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje, apo është i pallexueshëm.

6. Drejtoria rajonale tatimore, pasi kryen verifikimet përkatëse dhe vëren përmbushjen korrekte të kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin e fermerit në regjistrin tatimor duke evidentuar dukshëm në faqen e regjistrimit faktin që i regjistruari është “fermer” dhe lëshon certifikatën e regjistrimit (NIPT-in) brenda një afati prej dy ditësh nga data e paraqitjes së aplikimit. Emërtimi në certifikatë shkruan: “Fermeri A.B.” ku AB është emri dhe mbiemri i fermerit.

7. Ky regjistrim dhe certifikata e NIPT-it lëshuar fermerit është e vlefshme vetëm për qëllime të përfitimit nga skema e kompensimit të prodhuesve bujqësorë sipas këtij ligji. Çdo përdorim i NIPT-it të lëshuar fermerit nga ana e tij apo nga persona të tjerë për qëllime të tjera të ndryshme nga ajo e përcaktuar në këtë udhëzim është në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të tij.

Ndryshimet në regjistrim të fermerit

Nëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë prodhuese të fermerit ka ndryshime në të dhënat e regjistruara apo të deklaruara në momentin e regjistrimit të tij, si p.sh. të dhënat e identifikimit, vendit të ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore për shkak të tjetërsimit të tokës bujqësore apo çdo ndryshim tjetër, në të dhënat e deklaruara në momentin e regjistrimit etj., atëherë fermeri ose personi i autorizuar prej tij është i detyruar t'i deklarojë këto ndryshime në drejtorinë rajonale tatimore ku është pajisur me certifikatën e NIPT-it.

Drejtoria rajonale tatimore reflekton ndryshimet përkatëse në regjistrin tatimor përkatës.

Neni 7

Çregjistrimi i fermerit

1. Fermeri çregjistrohet në mënyrë vullnetare nëpërmjet aplikimit për çregjistrim, sipas formularit të miratuar për këtë qëllim duke dorëzuar në të njëjtën kohë certifikatën e NIPT-it në drejtorinë rajonale tatimore në të cilën kjo certifikatë është lëshuar. Drejtoria rajonale tatimore evidenton në regjistrin tatimor datën e dorëzimit të NIPT-it prej fermerit duke e bërë të pavlefshëm këtë NIPT. Në rast vdekjeje të fermerit, çregjistrimi kryhet me kërkesë të çdo personi të interesuar dhe me depozitim të dokumenteve përkatëse që vërtetojnë që personi është ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjykatë, duke dorëzuar në të njëjtën kohë certifikatën e NIPT-it e cila është lëshuar në emrin e tij.

2. Çregjistrimi i fermerit dhe dorëzimi i certifikatës së NIPTI-it në drejtorinë rajonale tatimore, përveç se bëhet për qëllime deklarimi, është i domosdoshëm për të shmangur keqpërdorimin e NIPT-it, pasi bën të pavlefshme çdo faturë tatimore në të cilën ky NIPT është shënuar, të lëshuar pas datës së çregjistrimit të fermerit. Personi i tatueshëm që ka përfituar zbritjen e TVSH-së së shënuar në faturën e lëshuar në emrin dhe për llogari të fermerit të çregjistruar, pas datës që çregjistrimi i tij ka hyrë në fuqi, nuk i lejohet të zbresë TVSH-në përkatëse dhe ndërkohë nëse e ka zbritur atë TVSH në shkelje të procedurës, i kërkohet të paguajë 100% TVSH-në e zbritur padrejtësisht.

Neni 8

Mënyra e zbatimit të skemës së kompensimit

1. Blerësi i produkteve bujqësore sipas këtij udhëzimi është person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në dhe i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së. Blerësi, person i tatueshëm, për çdo furnizim të produkteve bujqësore, të marrë prej fermerit, në përputhje me këtë udhëzim, lëshon një faturë tatimore me TVSH sipas formatit të miratuar të faturave nga organi tatimor, në të cilën evidenton si shitës, shitësin fermer (prodhues bujqësor), NIPT-in e fermerit dhe të dhënat e tjera të kërkuara sipas faturës.

2. Vlera totale e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit fermer, përfshirë normën e kompensimit e cila është 20%. TVSH-ja e shënuar në faturë prej 20% përbën normën e kompensimit të fermerit. Kompensimi i akorduar i paguhet fermerit nga blerësi, person i tatueshëm, për kundërt furnizimeve të kryera. Norma e kompensimit aplikohet mbi çmimin pa TVSH të mallrave, të përcaktuara sipas këtij udhëzimi.

3. Kompensimi ka për qëllim të mbulojë TVSH-në e paguar prej fermerëve në çmimin e blerjes së mallrave e shërbimeve, që ata kanë blerë për nevoja të kryerjes së aktivitetit të tyre prodhues bujqësor.

4. Çdo blerës i produkteve të fermerit që aplikon skemën e kompensimit, duhet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore përkatëse që është aplikues i skemës së kompensimit të fermerit përpara se të fillojë aplikimin e saj, duke e shoqëruar njoftimin me një akt marrëveshje midis palëve (blerësit të produkteve të fermerit, person i tatueshëm dhe fermerit), sipas modelit të aktmarrëveshjes bashkëngjitur këtij udhëzimi, ku palët bien dakord midis tyre të kryejnë

transaksione për produktet bujqësore, si shitës dhe blerës. Për çdo marrëveshje shitesë me një fermer të ri që blerësi person i tatueshëm hyn në transaksione duhet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore përkatëse. Mosnjoftimi në kohë dhe mosaplikimi korrekt sipas kësaj procedure i heq blerësit të drejtën e zbritjes së TVSH-së si normë e kompensimit të shënuar në faturën e lëshuar në emër të fermerit, marrëveshja me të cilin nuk i është dërguar (njoftuar) organit tatimor.

Drejtoria rajonale tatimore përkatëse mban një regjistër të veçantë duke evidentuar çdo person të tatueshëm që ka njoftuar se kryen blerje nga fermerë në kuadër të skemës së kompensimit të fermerit.

Neni 9

E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar

1. Kompensimi, që personi i tatueshëm blerës i ka paguar shitësit prodhues bujqësor, është TVSH e zbritshme për personin e tatueshëm blerës dhe deklarohet në periudhën tatimore kur është lëshuar fatura sipas datës së faturës. Fatura duhet të përmbajë dhe të plotësohet me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas rubrikave që ajo përmban. Blerësi person i tatueshëm në çdo faturë të lëshuar shkruan “Vetëfaturim i TVSH-së sipas regjimit për kompensim të fermerit”.

2. E drejta e zbritjes së TVSH-së së paguar fermerit, nga blerësi person i tatueshëm lind dhe ushtrohet sipas përcaktimeve të ligjit.

3. Nëse fatura nuk përmban të dhënat e plota dhe të sakta, si dhe nuk përmban shënimin “Vetëfaturim i TVSH-së sipas regjimit për kompensim të fermerit”, personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe detyrohet të paguajë dënimin, sipas nenit 128, për faturë tatimore të parregullt në përputhje me ligjin në fuqi “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 20% të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar sipas këtij neni, nëse nuk provon kryerjen e kompensimit të fermerit nëpërmjet likuidimit të vlerës së faturës nga llogaria bankare e tij në llogarinë bankare të fermerit, apo nëse ky likuidim i faturës, nuk është kryer nëpërmjet shërbimit të Postës Shqiptare. (Ndryshuar me Udhëzim Nr. 26, datë 26.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 188, datë 29 tetor 2015.)

(Fjalja e dytë e pikës 3, SHFUQIZOHET me UMF Nr. 10, datë 3.5.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.75, datë 5 maj 2016).

4. Blerësit nuk i njihet si e zbritshme TVSH-ja e kompensuar sipas kësaj skeme për produktet e blera nga fermerët të cilat dëmtohen, prishen, duke u bërë të papërdorshme prej tij.

5. Personi i tatueshëm, blerës me qëllim, që të ketë të drejtën e zbritjes së normës së kompensimit të TVSH-së të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar sipas këtij neni, për transaksione mbi 30 000 lekë, është i detyruar të kryejë likuidimin e vlerës së faturës nëpërmjet shërbimit të Postës Shqiptare ose nëpërmjet bankës, nëse vlera e transaksionit nuk e kalon shumën prej 150 000 lekësh dhe nëpërmjet likuidimit nga llogaria bankare e tij në llogarinë bankare të fermerit, për transaksione, vlera e të cilit është më e madhe se 150 000 lekë, siç përcaktohet në nenin 59 të ligjit, "Për procedurat tatimore në RSH".

Për transaksione sipas vlerës totale të faturës deri në 30 000 lekë, likuidimi me para në dorë vërtetohet me dokumentet përkatëse të kontabilitetit për dokumentimin e pagesave, duke pasur parasysh kushtin se brenda së njëjtës ditë, me të njëjtin fermer, nuk lejohet të kryhet më shumë se një transaksion deri në këtë vlerë.

6. Personi i tatueshëm blerës që eksporton produkteve e blera nga fermerët sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së u nënshtrohet rregullave të përcaktuara në nenin 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Personat e tatueshëm blerës që karakterizohen me risk zero sipas kritereve të vendimit të Këshillit të Ministrave, rimbursohen për TVSH-në, automatikisht, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 10, datë 3.5.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.75, datë 5 maj 2016).

Neni 10

Fatura tatimore dhe norma e kompensimit

1. Fatura tatimore e shitjes, e lëshuar nga personi i tatueshëm për prodhuesin bujqësor (fermerin), duhet detyrimisht të përmbajë të shënuara të dhënat e mëposhtme:

- Nr. serial të faturës;
- Datën e lëshimit të faturës;
- Kohën e furnizimit;
- Numrin rendor që mundëson identifikimin e faturës;
- Të dhënat e fermerit si emrin e fermerit sipas regjistrimit të tij;
- Adresën ku fermeri e ka veprimtarinë prodhuese;
- NIPT-in e fermerit;
- Të dhënat e blerësit, personit të tatueshëm, emrin, adresën e plotë të personit të tatueshëm;
- NIPT-in etj.;
- Përshkrimin, sasinë dhe njësinë matëse të mallrave;
- Vlerën e mallrave të blera pa TVSH;
- Shumën e kompensimit (TVSH-së së lloga-ritur dhe shumën totale për pagesë, përfshirë TVSH-në;

Fatura duhet të jetë e nënshkruar nga palët, shitësi dhe blerësi.

2. Në rastin kur blerësi personi i tatueshëm paraqitet në adresën e fermerit dhe transporton mallrat me mjetet e tij nga adresa e fermerit në adresën ku blerësi kryen veprimtarinë ekonomike, atëherë fatura tatimore i lëshohet fermerit nga blerësi në momentin që malli bëhet i disponueshëm prej blerësit, dhe fatura shoqëron mallin në adresën e blerësit. Në këtë rast në faturë shënohen edhe të dhënat e transportuesit.

3. Fermeri i pajisur me NIPT, nuk duhet të pajiset me blloqe të faturave tatimore me TVSH nga drejtoritë rajonale tatimore, pasi fatura në emër të fermerit lëshohet nga blerësi prej faturave tatimore të tij.

4. Blerësi i produkteve bujqësore plotëson faturën me të dhënat e kërkuara dhe në rolin e blerësit e mban vetë faturën origjinale, e cila i jep të drejtën e zbritjes së TVSH-së së shënuar në faturë. Shitësi fermer pajiset me kopjen e dytë të faturës tatimore me TVSH, faturë e cila ruhet prej tij si dokument që vërteton furnizimin (shitjen) e kryer.

5. Personi i tatueshëm blerës i produkteve të fermerit, i cili për zbatimin e kësaj skeme ngarkohet të lëshojë faturë tatimore, jo vetëm për shijet që kryen, por edhe faturë në emër të fermerit si blerës i produkteve të tij, lejohet të përdorë faturë tatimore kompjuterike me numër serial unik dhe të papërsëritshëm të printuar nga sistemi i tij i regjistrimeve.

5.1 Për këtë qëllim, personi i tatueshëm duhet të paraqesë:

- a) Një kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, në të cilën të tregojë se sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm për çdo transaksion dhe që lëshon një numër të konsiderueshëm faturash;
- b) Modelin e faturës kompjuterike që kërkon të përdorë, model i cili duhet të përmbajë të gjitha të dhënat në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

Drejtoria Rajonale Tatimore, sigurohet që fatura tatimore kompjuterike përmban të gjitha të dhënat e nevojshme dhe brenda 7 ditëve, një kopje të kërkesës, modelin e faturës tatimore kompjuterike dhe opinionin e saj e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

5.2 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 7 ditësh miraton përdorimin e faturës tatimore kompjuterike, sipas modelit të kërkuar dhe njofton personin e tatueshëm dhe drejtorinë rajonale tatimore, e cila i dorëzon personit të tatueshëm zyrtarisht diapazonin e numrave serialë që duhet të përmbajë çdo faturë. Çdo faturë e lëshuar sipas modelit të miratuar përmban detyrimisht shënimin, "Përdorimi i kësaj fature është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me shkresën nr. ..., datë...".

5.3 E drejta për të përdorur modelin e miratuar të faturës tatimore kompjuterike për personin e tatueshëm fillon pasi është pajisur me diapazonin e numrave serialë që duhet të përmbajë çdo faturë. Numri serial është unik dhe i papërsëritshëm për çdo faturë të lëshuar.

5.4 Për çdo ndryshim në modelin, përmbajtjen, formatin e faturës kompjuterike për të cilën është miratuar e drejta e përdorimit, personi i tatueshëm duhet të kërkojë miratim të modelit të ndryshuar të faturës tatimore.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 10, datë 3.5.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.75, datë 5 maj 2016).

Neni 11 **Deklarimi**

1. Për çdo blerje nga fermerët sipas kësaj skeme, personi i tatueshëm blerës faturën e blerjes për mallin e blerë nga fermerët e regjistron në kutitë përkatëse të librit të blerjes me përcaktimin “Vlera e tatueshme/nga fermerë vendas” dhe në një kuti të veçantë, regjistrohet vlera që i korrespondon normës së kompensimit si produkt i vlerës së tatueshme të mallit me përqindjen e kompensimit, e cila sipas këtij ligji është 20%. Këto vlera regjistrohen nga personi i tatueshëm për çdo muaj në deklaratën “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të periudhës përkatëse dhe deklarohen në muajin pasardhës të periudhës tatimore së cilës i përket deklarimi.

2. Për qëllime të llogaritjes së normës së kompensimit në masën 20%, kjo normë do të aplikohet për furnizimet e kryera prej fermerëve pas pajisjes së tyre me certifikatën e NIPTIT-it, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë udhëzim.

Shembull

Një fermer vreshtar i identifikuar si individ A.B., që kryen veprimtarinë si prodhues bujqësor në vreshtari duke kultivuar (prodhuar) rrush, i shet rrushin shoqërisë X, një përpunuesi dhe prodhuesi

verërash i regjistruar si person i tatueshëm për TVSH-në. Vlera e mallit të shitur nga fermeri A.B. për shoqërinë X është 30.000 lekë. Pra shoqëria X i detyrohet fermerit A.B. për vlerën 30.000 lekë.

Detyrimet e fermerit

Fermeri A.B. për të përfituar nga skema e kompensimit duhet të regjistrohet në drejtorinë rajonale tatimore për t'u pajisur me NIPT brenda dy ditësh pune. Drejtoria rajonale tatimore pajis me certifikatë NIPT-i fermerin, duke shënuar si emër "Fermeri A.B." dhe NIPT-in që gjeneron sistemi.

Detyrimet e personit të tatueshëm

Ndërkohë përpunuesi i rrushit, shoqëria X, përpara se të lëshojë faturën e parë në emër të fermerit, duhet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore përkatëse që është aplikues i skemës së kompensimit të fermerit duke i bashkëngjitur dhe marrëveshjen me fermerin.

Personi i tatueshëm, në momentin që ka marrë furnizimin prej fermerit, përpilon faturën tatimore të shitjes me TVSH. Në të dhënat identifikuese personi përgjegjës i blerësit që plotëson faturën në të dhënat e shitësit shënon emrin e fermerit sipas regjistrimit përkatës

"Fermeri A.B."; NIPT: L.....N dhe të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit të faturës.

Përsa i përket furnizimit në rubrikën përkatëse të faturës shënohen përkatësisht të dhënat e kërkuara mbi përshkrimin e mallit, njësinë dhe sasinë, çmimin për njësi, etj.

Sipas shembullit ku vlera e furnizimit është 30.000 lekë, pra kjo është vlera që blerësi person i tatueshëm do t'i paguajë shitësit fermer, në faturë në vlerën e tatueshme do të shënohet vlera 25.000 lekë, në kutinë e TVSH-së do të llogaritet norma e kompensimit 20% e vlerës së tatueshme pra $25.000 \text{ lekë} \times 20\% = 5.000 \text{ lekë}$ dhe vlera totale e furnizimit 30.000 lekë.

Në faturë duhet të shkruhet dukshëm "Vetëfaturim i TVSH-së sipas regjimit për kompensim të fermerit". Nëse fatura nuk ka këtë shënim, personit të tatueshëm X nuk i lejohet të zbresë TVSH-në e faturës.

Fatura origjinale do të mbahet nga blerësi i produkteve dhe fermerit i jepet kopja e dytë e faturës. Kjo faturë nga personi i tatueshëm blerës regjistrohet në librin e blerjes në rubrikat përkatëse "Blerje nga fermerë", ilustruar si në librin bashkëngjitur.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Arben Ahmetaj

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 172, datë 11.11.2014.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 23, datë 07.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 157, datë 11.09.2015.

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 26, datë 26.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 188, datë 29 tetor 2015.

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 10, datë 3.5.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.75, datë 5 maj 2016

shtuar”

3. Kushtet e fermerit

Fermeri që kryen veprimtari prodhuese bujqësore _____ (përshkrimi i veprimtarisë) _____ merr përsipër të shesë (furnizojë) personin e tatueshëm me produkte bujqësore të llojit si më poshtë:

1. _____;

2. _____;

3. _____; etj

4. Kushtet e personit të tatueshëm blerës.

4.1 Nga ana e tij personi i tatueshëm për TVSH-në blerës i këtyre produkteve në momentin e disponimit të produkteve bujqësore, garanton se do të pajisë fermerin me fature tatimore me TVSH, (si furnizues - kopje e dytë e faturës) të plotësuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe fermeri nënshkruan faturën tatimore dhe ruan kopjen që i vihet në dispozicion nga blerësi.

4.2 Personi i tatueshëm, blerës i produkteve bujqësore prej fermerit garanton se i përdor këto produkte në kuadër dhe vetëm për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike.

5. Vlera e furnizimit

Vlera e furnizimit dokumentohet sipas faturës tatimore me TVSH, e cila përmban dhe plotësohet me të dhënat e kërkuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore ku bazohet kjo marrëveshje.

6. Afati i marrëveshjes

6.1 Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 3 akte format origjinal, një për fermerin dhe dy për personin e tatueshëm blerës, i cili një kopje e paraqet në drejtorinë rajonale tatimore ku është i regjistruar.

6.2 Për çdo ndryshim ose zgjidhje të kësaj marrëveshje, personi i tatueshëm blerës detyrohet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore.

6.3 Kjo marrëveshje lidhet për një afat _____.

7. Të tjera midis palëve

Shënim. Palët sipas gjykimit të tyre përveç sa më sipër, mund të parashikojnë në këtë marrëveshje kushte të tjera që nuk bien ndesh dhe nuk cenojnë kërkesat e kësaj marrëveshjeje dhe dispozitat përkatëse ligjore.

Administratori i personit të tatueshëm
(Emër, mbiemër, nënshkrimi, vula)

Fermeri
(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE DRBZHRAU _____

Nr. Prot. _____

VËRTETIM

Me anë të të cilit vërtetojmë se _____ (emër, atësia, mbiemër) _____
me letërnjoftim (ID) nr. _____, ushtron aktivitetin si fermer në veprimtarinë
bujqësore _____ (përshkrimi i veprimtarisë/ve bujqësore që kryen fermeri)

_____ me adresë _____ (bashkia/fshati/etj).

Ky vërtetim lëshohet për qëllime të pajisjes me NIPT të fermerit në Drejtorinë Rajonale Tatimore .

DREJTORI RAJONAL
(nënshkrimi/vula)

Shënim

Ky vërtetim është i vlefshëm 30 ditë nga data e lëshimit të tij prej autoritetit përkatës dhe lëshohet sipas kërkesave të udhëzimit nr. datë të ministrit të Financave në zbatim të nenit 159 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Në drejtorinë rajonale tatimore dorëzohet formati origjinal i këtij vërtetimi.